



28–29 November 2018 · Vienna, Austria

## STAREP AACOP dhe EU-REPARIS FRCOP

Organized by the World Bank's Centre for Financial Reporting Reform



WORLD BANK GROUP

Under the auspices of

e 20  
u 18  
- a t

Austrian  
Presidency  
of the  
Council of the  
European Union

The events are supported by the following programs

PULSARO



STAREP

The programs are co-founded by



AUSTRIAN  
DEVELOPMENT  
COOPERATION

Federal Ministry  
Republic of Austria  
Finance



European Union



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra



# **INFORMACIONI FINANCIAR: KATALIZATOR I INTEGRIMIT**

---

## **SEMINAR I PËRBASHKËT I KOMUNITETEVE TË PRAKTIKËS TË PROGRAMEVE PULSAR, STAREP DHE EU-REPARIS**

### **RAPORTIMI FINANCIAR NË SEKTORIN PRIVAT DHE SEKTORIN PUBLIK - ÇËSHTJE TË PËRBASHKËTA, SFIDAT DHE ZHVILLIMET E FUNDIT**

Në këtë seminar do të mbliidhen pjesëmarrës nga tri programe rajonale, që mbulojnë 13 vende, të cilët janë **STAREP** (Armenia, Azerbajxhani, Bjellorusia, Gjeorgjia, Moldavia dhe Ukraina), **EU-REPARIS** (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, IRJ e Maqedonisë, Mali i Zi dhe Serbia) dhe **PULSAR** (Shqipëria, Armenia, Azerbajxhani, Bjellorusia, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Gjeorgjia, Kosova, IRJ e Maqedonisë, Moldavia, Mali i Zi, Serbia dhe Ukraina). Si mysafirë të aktivitetit, do të marrin pjesë edhe pjesëmarrës nga Republika e Kirgizisë.

Objektivi kryesor i seminarit është të diskutohen mundësitë dhe sfidat aktuale të lindura nga teknologjia në fushën e të bërit biznes dhe të raportimit mbi biznesin, dhe si ndikojnë në kornizat ligjore dhe profesionistët lidhur me drejtimin e brendshëm dhe kontabilitetin.

Objektivat e seminarit janë:

- Të kuptohet më mirë si po ndryshon teknologjia e lidhur me mënyrën e administrimit dhe raportimit të biznesit, dhe si po ndryshojnë ndërveprimet midis palëve të interesit;
- Të shihet se si ndryshimet teknologjike ndikojnë në rolin e profesionit kontabël në sektorin publik dhe privat;
- Të shqyrtohet ndikimi që kanë dështimet organizative të kohëve të fundit dhe krizat e borxhit publik, përfshirë rrjedhojat për profesionin kontabël në sektorin publik dhe atë privat;
- Të diskutohet për çështje që lidhen me rritjen e transparencës, uljen e riskut fiskal dhe përmirësimin e mekanizmave të llogaridhënies të ndërmarrjeve shtetërore (NSH) kundrejt Shtetit.

Përveç kësaj, gjatë ditës së dytë të seminarit pjesëmarrësit e programeve rajonale STAREP dhe EU-REPARIS do të mësojnë në lidhje me: i) përvojën për delegimin e funksioneve dhe përgjegjësi të caktuara nga organet e mbikëqyrjes publike te organizatat e profesionit kontabël (OPK) dhe ii) përvojën e FRC-së mbi mënyrën e zhvillimit të një sistemi të sigurimit të cilësisë.

Së fundi, në seminar do të paraqitet një kuadër të ri i rezultateve të reformës së kontabilitetit dhe auditimit, që mat progresin e arritur në vendet pjesëmarrëse të programit STAREP dhe do t'u jepet mundësi pjesëmarrësve të programit STAREP dhe EU-REPARIS të shohin përfitimet e krijimit të një kuadri të matjes së rezultateve, duke theksuar rezultatet kyçe të arritura me përkrahjen e CFRR të Bankës Botërore gjatë periudhës 2013-2018.

# PROGRAMI / 28 NËNTOR 2018 / SEANCAT E PËRBASHKËTA TË KOMUNITETEVE TË PRAKTIKËS TË PROGRAMEVE STAREP, EU-REPARIS DHE PULSAR

---

**08:30** Regjistrimi dhe kafeja e mirëseardhjes

---

**08:40** Fjalët e mirëseardhjes

**Dan Boyce** · *Menaxher Praktike, Praktika Globale për Qeverisjen, Banka Botërore*

---

**09:00** Objektivat dhe qëllimi i seancave të përbashkëta të programeve PULSAR, STAREP dhe EU-REPARIS

**Arman Vatyan** · *Kryespecialist për drejtimin financiar, Praktika Globale për Qeverisjen, Banka Botërore*

**Andrei Busuioc** · *Specialist i lartë për drejtimin financiar, CFRR, Banka Botërore*

**Pascal Frerejacque** · *Nëpunës i lartë për operacionet, CFRR, Banka Botërore*

---

**09:10** Si po ndikon teknologjia në biznesin, në raportimin financiar publik dhe privat dhe në marrëdhëniet mes grupeve të interesit

**Erik P.M. Vermeulen** · *Profesor i së drejtës tregtare dhe financiare, Universiteti Tilburg dhe Qendra Tilburg për Shkenca Juridike dhe Ekonomike*

**Matthias Lichtenthaler** · *Drejtor i Transformimit Digjital, BRZ*

**Scott Layton** · *Drejtor i Auditimit dhe Hetimit, IBM*

Drejtues seance:

**Pascal Frerejacque** · *Nëpunës i lartë për operacionet, CFRR, Banka Botërore*

Prej kohësh kontabilistët kanë hequr dorë nga mbrojtëset e mëngëve dhe blloqet dhe regjistrat fizikë, që përdornin përpara revolucionit të teknologjisë informatike. Revolucion i ri digjital, zhvillimet e inteligjencës artificiale, analitika e të dhënave dhe teknologjitë *blockchain* janë duke ndikuar ndjeshëm në mënyrën e të bërit biznes dhe luajnë rol thelbësor në përmirësimin e procesit të dhënies së informacioneve shpjeguese dhe raportimit të shoqërive tregtare. Vala më e re e teknologjive digjitale mund t'i trajtojë tashmë këto shërbime me vlerë të shtuar dhe të arrijë brenda pak orëve atë që kërkonte javë të tëra më parë. Në këtë seancë do të diskutohet për përfitimet që mund të sjellë teknologjia në raportimin financiar, krahas risqeve, shumë prej të cilave ende nuk janë kuptuar plotësisht.

# PROGRAMI / 28 NËNTOR 2018 / SEANCAT E PËRBASHKËTA TË KOMUNITETEVE TË PRAKTIKËS TË PROGRAMEVE STAREP, EU-REPARIS DHE PULSAR

---

10:40 Pushim për kafe

---

11:00 Diskutim në panel mbi rolin në ndryshim e sipër të profesionit kontabël

Folës në panel:

**Kirstin Gillon** · Përgjegjëse teknike, Trupa Akademike Informatike, Instituti i Kontabilistëve të Autorizuar në Angli dhe Uells (ICAEW)

**Sylvia Tsen** · Drejtoreshë Ekzekutive, Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC)

**Stephen L. Muscat** · Shef Finance dhe Sekretar i Shoqërisë, Liquigas Malta Limited

Diskutues:

**Ed Olowo Okere** · Drejtor, Praktika Globale për Qeverisjen, Banka Botërore

Drejtues seance:

**Ana Cristina Hirata Barros** · Specialiste e lartë për drejtimin financiar, CFRR, Banka Botërore

Një profesion kontabël kompetent mund të mbështesë zhvillimin e sektorit privat nëpërmjet të dhënave më të mira, më të besueshme dhe transparente financiare. Kontabilistët dhe audituesit kontribuojnë në shpërndarjen dhe administrimin efikas të burimeve dhe i ndihmojnë shoqëritë tregtare të thithin investime dhe të marrin kredi. Profesionit kontabël mbështet edhe një sektor publik që është më transparent dhe jep llogari përpara qytetarëve: raportimi financiar efektiv ka rëndësi kritike që qeveritë të kuptojnë pozicionin dhe perspektivën e tyre fiskale, por ka po aq rëndësi për t'u vënë në dispozicion ligjvënësve, tregjeve dhe qytetarëve informacionet që u duhen për të marrë vendime politike efikase dhe për t'u kërkuar llogari qeverive për punën që bëjnë. Prej kohësh kontabilistët kanë hequr dorë nga mbrojtëset e mëngëve dhe blloqet dhe regjistrat fizikë. Mënyra se si shtojnë vlerë kontabilistët po ndryshon vitet e fundit, për shkak të kërkesave në rritje të tregjeve dhe qytetarëve, si edhe për shkak të përparimeve revolucionare në teknologji. Kjo seancë do të fokusohet te mënyra se si po zhvillohet profesioni për të qenë një hap përpara zhvillimeve dhe për t'u përgatitur për të ardhmen.

---

12:25 Foto grupi /informacioni i hollësishëm do të jepet më vonë/

# PROGRAMI / 28 NËNTOR 2018 / SEANCAT E PËRBASHKËTA TË KOMUNITETEVE TË PRAKTIKËS TË PROGRAMEVE STAREP, EU-REPARIS DHE PULSAR

---

12:35 Dreka

---

13:45 Fjala e mirësearchjes

**Mercy Tembon** · Drejtoreshë Rajonale për Kaukazin Jugor, Banka Botërore

---

14:00 Ndikimi që kanë skandalet e kohëve të fundit në profesionin kontabël, përfshirë vështirësitë e hasura, në sektorin publik

**Mark Mainwaring** · Kontrolli teknik dhe i cilësisë, UK FRC - Dega e Kontrollit të Cilësisë së Auditimit dhe anëtar i grupit të punës për MPIA-në

**Bernhard Schatz** · Auditues, pasqyrat financiare/raporti për pasqyrën financiare federale, Gjykata e Kontrollit, Austri

Drejtues seance:

**Arman Vatyan** · Kryespecialist për drejtimin financiar, Praktika Globale për Qeverisjen, Banka Botërore

**Abbas Kizilbash** · Specialist i lartë për drejtimin financiar, CFRR, Banka Botërore

Profesioni kontabël vijon të përballet me sfida të konsiderueshme të cilat kanë dalë në pah nga dështimet e vazhdueshme të raportimit financiar. Qëllimi i kësaj seance është të diskutohet se si u është përgjigjur këtyre sfidave profesioni kontabël dhe se si do të duhet të zhvillohen profesionistët kontabël, përfshirë kontabilistët dhe zyrtarët e sektorit publik, për t'u bërë ballë këtyre zhvillimeve dhe sfidave.

Në fund të prezantimeve do të ketë një seancë me pyetje dhe përgjigje.

---

15:15 Pushim për kafe

# PROGRAMI / 28 NËNTOR 2018 / SEANCAT E PËRBASHKËTA TË KOMUNITETEVE TË PRAKTIKËS TË PROGRAMEVE STAREP, EU-REPARIS DHE PULSAR

---

## 15:35 Ndërmarrjet shtetërore (NSH) në objektin e llogarive publike: rritja e transparencës dhe përmirësimi i mekanizmave të llogaridhënies

**Andrei Busuioc** · *Specialist i lartë për drejtimin financiar, CFRR, Banka Botërore*

**Natalie Manuilova** · *Specialiste e lartë për drejtimin financiar, Praktika Globale për Qeverisjen, Banka Botërore*

Drejtues:

**Abbas Kizilbash** · *Specialist i lartë për drejtimin financiar, CFRR, Banka Botërore*

**Ana Cristina Hirata Barros** · *Specialiste e lartë për drejtimin financiar, CFRR, Banka Botërore*

**Pascal Frerejacque** · *Nëpunës i lartë për operacionet, CFRR, Banka Botërore*

Diskutues:

**Mercy Tembon** · *Drejtoreshë Rajonale për Kaukazin Jugor, Banka Botërore*

Mënyra si drejtohen dhe monitorohen NSH-të mund të ndikojë në ecurinë e tyre financiare. Ndërkohë që NSH-të e shëndetshme janë pasuri me vlerë për shtetin, me kontribute pozitive në buxhet nëpërmjet dividendëve dhe tatime të paguara, humbjet ose futja e tepruar në borxh e NSH-ve sjellin detyrime faktike dhe të kushtëzuara, të cilat mund të kërkojnë injektim kapitali dhe forma të tjera mbështetjeje. Qëllimi i kësaj seance është diskutimi i bazave të drejtimit të brendshëm të NSH-ve dhe i praktikave të mira për monitorimin financiar të NSH-ve. Në seancë do të prezantohen dhe diskutohen edhe zgjidhje për të fuqizuar drejtimin e brendshëm të ndërmarrjeve shtetërore dhe për të zvogëluar risqet financiare ndaj të cilave mund ta ekspozojnë shtetin. Seanca do të jetë ndëraktive dhe do të përqendrohet te një rast studimor dhe prezantime të shkurtra.

---

## 16:45 Fundi i seminarit

# PROGRAMI / 29 NËNTOR 2018 / SEANCAT E PËRBASHKËTA TË KOMUNITETEVE TË PRAKTIKËS TË PROGRAMEVE STAREP DHE EU-REPARIS

---

**08:30 Kafeja e mëngjesit**

---

**09:00 Delegimi i detyrave të organeve të mbikëqyrjes profesionale (OMP) te organizatat e profesioneve kontabël (OPK)**

**Ranjan Ganguli** · *Konsulent i lartë për drejtimin financiar, CFRR, Banka Botërore*

Drejtues seance:

**Jarett Decker** · *Drejtor, CFRR, Banka Botërore*

Në BE, organet e mbikëqyrjes publike (OMP) ose autoritetet kompetente kanë përgjegjësinë finale për mbikëqyrjen e audituesve, përfshirë: i) aprovimin dhe regjistrimin e audituesve ligjorë dhe firmave të auditimit ligjor; ii) miratimin e standardeve për etikën profesionale, kontrollin e brendshëm të cilësisë së firmave të auditimit dhe auditimit; iii) formimin e vazhduar; iv) sistemet e sigurimit të cilësisë dhe v) raportimin e sistemeve disiplinore hetimore dhe administrative. BE u lejon OMP-ve të delegojnë disa nga këto detyra, prandaj qëllimi i kësaj seance është të diskutohet për përvijën e OMP-ve në delegimin e detyrave të tyre. Seanca do të përqendrohet se cilat detyra delegohen dhe cilat nuk delegohen nga OMP-të në të gjithë Evropën, si shprehet delegimi, si vendosin OMP-të se cilat detyra do të delegohen dhe si e monitorojnë kryerjen e detyrave të deleguara OMP-të. Në fund të prezantimit do të ketë një seancë me pyetje dhe përgjigje.

---

**10:30 Pushim për kafe**

---

**11:00 Zhvillimi i një sistemi të sigurimit të cilësisë - si të ndërtohet një model efektiv**

**Mark Mainwaring** · *Kontrolli teknik dhe i cilësisë, UK FRC - Dega e Kontrollit të Cilësisë së Auditimit dhe anëtar i grupit të punës për MPIA-në*

Drejtues seance:

**Andrei Busuioc** · *Specialist i lartë për drejtimin financiar, CFRR, Banka Botërore*

Kjo seancë vjen në vijim të prezantimit dhe diskutimeve të zhvilluara gjatë aktivitetit të mëparshëm, me qëllim të thellimit të njohurive të pjesëmarrësve në lidhje me metodikën e zhvillimit dhe zbatimit të inspektimeve të kontrollit të cilësisë, mbështetur në shembuj nga jeta reale, praktikat e mira oëer kriteret e përzgjedhjes dhe kërkesat e kualifikimit për inspektorët e kontrollit të cilësisë. Në fund të prezantimit do të ketë një seancë me pyetje dhe përgjigje.



# PROGRAMI / 29 NËNTOR 2018 / SEANCAT E PËRBASHKËTA TË KOMUNITETEVE TË PRAKTIKËS TË PROGRAMEVE STAREP DHE EU-REPARIS

---

12:30 Dreka

---

13:30 Në rrugën drejt përmirësimit të raportimit financiar të shoqërive tregtare

Drejtues:

**Pascal Frerejacque** · *Nëpunës i lartë për operacionet, CFRR, Banka Botërore*

**Andrei Busuioc** · *Specialist i lartë për drejtimin financiar, CFRR, Banka Botërore*

**Svetlana Platon** · *Konsulente, CFRR, Banka Botërore*

Në këtë seancë do të jepet një pamje e përgjithshme e statusit aktual të reformave të raportimit financiar të shoqërive tregtare në secilin nga gjashtë vendet që marrin pjesë në programin STAREP (Armenia, Azerbajxhani, Bjellorusia, Gjeorgjia, Moldavia dhe Ukraina), duke theksuar rezultatet kyçe të arritura me mbështetjen rajonale të projektit gjatë periudhës 2013-2018.

Pjesëmarrësit do të nxiten të diskutojnë për statusin e reformave në zbatim në vendet e tyre, të shprehin pikëpamjet e tyre dhe të japin mendime dhe sugjerime.

---

15:30 Përmbledhje e seminarit, hapat në vijim dhe fjala mbyllëse

**Adenike Oyeyiola** · *Menaxhere Praktike, Praktika Globale për Qeverisjen, Banka Botërore*

---

16:00 Pushim për kafe dhe fundi i seminarit

# FOLËSIT / SEANCA TË PËRBASHKTA TË KOMUNITETEVE TË PRAKTIKËS TË PROGRAMEVE STAREP, EU-REPARIS DHE PULSAR

---



## KIRSTIN GILLON

Përgjegjëse teknike, Trupa Akademike Informatike, Instituti i Kontabilistëve të Autorizuar në Angli dhe Uells (ICAEW)

Kirstin Gillon udhëheq programin e ICAEW për udhëheqjen e mendimit mbi teknologjinë. Në këtë rol, ajo analizon se si ndikojnë në biznes dhe në profesionin kontabël trendët teknologjik siç janë *big data*, inteligjenca artificiale dhe siguria kibernetike. Ajo publikon gjerësisht mbi këto tema, diskuton me komunitetin e biznesit, akademik dhe politik dhe është folëse e rregullt në konferenca. Publikimet e saj të fundit përfshijnë "Inteligjenca artificiale dhe e ardhmja e kontabilitetit", "Të dhënat e mëdha në bizneset kineze" dhe "Çfarë mund të mësojmë nga auditimi"; Seria mbi Sigurinë Kibernetike. Përpara se të kalonte në ICAEW ka punuar si konsulentë informatike për PwC, ndërsa më parë ka punuar në IBM si menaxhere projekti dhe analiste biznesi.



## SCOTT LAYTON

Drejtor i Auditimit dhe Hetimit, IBM

Scott Layton është Drejtor i Auditimit dhe Hetimit për Grupin e Azisë dhe Paqësorit të IBM-së. Ka mbi 15 vjet që punon në IBM, në fushën financiar dhe në operacione, ndërsa me më shumë se një të dytën e karrierës e ka në Azi. Scott është i pasionuar pas teknologjive të reja dhe gjithmonë punon për të përgatitur dhe vënë në zbatim mjete, metodika dhe analiza të reja, duke ngritur njëkohësisht kapacitetin organizativ. Projekti i tij më i fundit përqendrohet në përdorimin e teknologjisë njohëse për të analizuar raportet e auditimit. Puna në një shoqëri teknologjike si IBM, i ka dhënë mundësinë unike për të njohur zhvillimet më të fundit dhe projektet dhe parimet që priten në këto fusha të reja biznesi.



## **MATTHIAS LICHTENTHALER**

Drejtor i Transformimit Digjital, BRZ

Matthias Lichtenthaler (PMP) punon si Drejtor i Transformimit Digjital pranë këshillit drejtues të Qendrës Kompjuterike Federale të Austrisë. Bashkërendon nisma të ndryshme si pjesë e Dokumentit Udhërrëfyes Digjital për Austrinë – përfshirë zgjidhjet e partneritetit publik-privat që mbështeten në lidhjen midis sektorit publik dhe privat. Në të shkuarën ka fituar përvojë të gjerë në menaxhimin e përmbajtjes dhe të dhënave, analizën njohëse dhe automatizimin e proceseve. Aktualisht punon me fokus në përshtatjen me trendët më të fundit të teknologjisë, si inteligjenca artificiale dhe Blockchain për sektorin publik. Më parë ka drejtuar biznesin digjital pranë firmës "Accenture" në Austri.



## **MARK MAINWARING**

Kontrolli teknik dhe i cilësisë, UK FRC – Dega e Kontrollit të Cilësisë së Auditimit dhe anëtar i grupit të punës për MPIA-në

Mark Mainwaring është anëtar i ekipit të kontrollit teknik dhe të cilësisë të AQR-së prej 5 vjetësh, ku ka shqyrtuar më shumë se 300 inspektime të 350 auditimeve FTSE. Më parë ka punuar në pozicione teknike dhe pozicione të punës me klientë në profesionin e auditimit, përfshirë edhe 12 vjet si Shef i Metodikës së Auditimit në BDO dhe 5 vjet si Shef i Auditimit dhe Sigurimit të Pensioneve në Grant Thornton. Marku është diplomuar për gjuhë moderne dhe mesjetare në Universitetin e Oksfordit dhe është kontabilist i autorizuar.



## **STEPHEN L. MUSCAT**

Shef Finance dhe Sekretar i Shoqërisë, Liquigas Malta Limited

Stephen L. Muscat është emëruar në Komitetin PAIB të IFAC në janar 2018. Është propozuar nga Instituti i Kontabilistëve të Maltës (MIA), anëtar i të cilit është prej vitit 1992. Zoti Muscat është aktualisht Kryetar i Komitetit MIA në PAIB, post të cilin e mban që prej vitit 2012, ndërsa ka shërbyer në këtë komitet që nga fillimi i tij. Zoti Muscat aktualisht mban postin e Shefit të Financës dhe Sekretarit të Shoqërisë për "Liquigas Malta Limited", operatori kryesor në importimin dhe shpërndarjen e gazit të lëngshëm në Maltë, post të cilin e mban prej 9 vjetësh. Përpara kësaj, ka punuar në sektorin prodhues për 14 vjet. Zoti Muscat është edhe Zëvendësnënkryetar i Shoqatës së Punëdhënësve të Maltës (MEA), post të cilin e mban prej 5 vjetësh, ku më parë ka qenë Sekretar Nderi dhe Përgjegjës Thesari Nderi i kësaj shoqate.



### **BERNHARD SCHATZ**

Auditues, pasqyrat financiare/raporti për pasqyrën financiare federale, Gjykata e Kontrollit, Austri

Bernhard Schatz aktualisht punon si ekspert i lartë i kontabilitetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara në Gjykatën e Kontrollit, Austri. Zoti Schatz ka punuar në Drejtorinë e Buxhetit të Ministrisë së Financave për më shumë se 10 vjet dhe ka marrë pjesë në ekipin e projektit për kalimin në vitin 2013 të Buxhetit Austriak nga kontabiliteti dhe sistemi buxhetor me baza monetare drejt kontabilitetit dhe sistemit buxhetor me të drejta dhe detyrime të konstatuara. Për shumë vjet ka qenë anëtar i disa këshillave mbikëqyrës të shoqërive shtetërore në Austri, si edhe i Grupit të Punës të Komisionit Evropian për Standardet Evropiane të Kontabilitetit të Sektorit Publik, ku përfaqësonte Austrinë. Prej muajit janar 2016 është anëtar i Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (BSNKSP).



### **SYLVIA TSEN**

Drejtoreshë Ekzekutive, Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC)

Sylvia Tsen është përgjegjëse për nismat e IFAC për praktikat e vogla dhe për njësitë ekonomike të vogla dhe të mesme; kontabilistët profesionistë në nismat e biznesit, përfshirë raportimin e integruar dhe trendët teknologjikë; Global Knowledge Gateway, një burim informacioni në internet për kontabilistët profesionistë; Komitetin e Kandidatëve; Operacionet dhe TI; dhe Forumin e Firmave dhe Komitetin Ndërkombëtar të Audituesve. Karriera profesionale e Sylvia-s përfshin punën pranë Departamentit Ndërkombëtar të KPMG-së mbi zbatimin e SNRF-ve dhe Komitetit të Menaxhimit të Riskut të KPMG-së, dhe si menaxhere auditimi në Zelandën e Re dhe Kanada. Zonja Tsen është diplomuar në Universitetin e Kolumbisë Britanike (Kanada). Ajo është kontabiliste e autorizuar e kualifikuar në Kanada dhe anëtare e CPA Kanada.



### **ERIK P.M. VERMEULEN**

Profesor i së drejtës tregtare dhe financiare, Universiteti Tilburg dhe Qendra Tilburg për Shkenca Juridike dhe Ekonomike (TILEC), Vendet e Ulëta.

Puna kërkimore e Erik Vermeulen përqendrohet në drejtimin e brendshëm të organizatave nesër. Objektivi madhor i drejtimit të brendshëm të organizatave nesër është të kuptohet se çfarë lloj mjedisi i maksimizon mundësitë për sukses në botën digjitale. Kjo ka lidhje me mediat sociale, platformat kolegjiale, internetin e sendeve, teknologjinë e zinxhirit me blloqe, metadat, robotikën dhe inteligjencën artificiale. Drejtimi i së nesërme ka të

bëjë me identifikimin e elementeve përbërëse dhe arkitekturën rregullatore që mund të rrisë produktivitetin e bizneseve dhe kreativitetin dhe përmbushjen e të gjitha palëve të interesit. Erik është gjithashtu përgjegjës i drejtimit të brendshëm pranë shoqërisë "Philips Lighting" (shoqëri teknologjike) në Vendet e Ulëta. Mendimet novatore dhe diskutim-nxitëse të Erikut në lidhje me biznesin dhe drejtimin e brendshëm kanë tërhequr vëmendje ndërkombëtare. Ai punon rregullisht si ekspertë këshilltar për organizata ndërkombëtare. Ai ka marrë pjesë në konferenca të shumta si folës kryesor ose si prezantues.



### **ED OLOWO-OKERE**

Drejtor, Praktika Globale për Qeverisjen, Banka Botërore

Ed Olowo-Okere është Drejtor i Praktikës Globale për Qeverisjes të Grupit të Bankës Botërore për Afrikën, Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut dhe Evropën dhe Azinë Qendrore, ku mbikëqyr strategjitë, programet dhe stafin e qeverisjes. Gjithashtu mbikëqyr aktivitetet në fushat tematike të MFP-së, ndërmarrjeve shtetërore, qeverisjes digjitale dhe standardeve të qeverisjes financiare. Është Drejtor i Familjes së Drejtimit Financiar pranë Bankës Botërore, e përbërë nga personeli që punon për aspektet e besnikërisë të veprimtarive të Bankës Botërore dhe asistencës teknike për menaxhimin financiar në sektorët publikë dhe privatë. Ai udhëheq ndërveprimet e Bankës Botërore me partnerët globalë në temat e lartpërmendura. Aktualisht, kryeson/bashkëkryeson Grupin e Donatorëve të INTOSAI-t, Komitetin Drejtues të Donatorëve të INTOSAI-t dhe Komitetin Drejtues të Donatorëve të IFAC (MOSAIC).



### **MERCY TEMBON**

Drejtoreshë Rajonale për Kaukazin Jugor, Banka Botërore

Mercy Tembon është Drejtoreshë Rajonale për Kaukazin Jugor prej muajit tetor 2015, ku udhëheq ekipet në nivel vendi në dhënien e njohurive, organizimin e takimeve dhe financimin e shërbimeve në përgjigje të kërkesave dhe nevojave të klientëve, për të kontribuar në qëllimin e dyfishtë të Bankës Botërore për t'i dhënë fund varfërisë së skajshme dhe për të nxitur prosperitetet për të gjithë. Zonja Tembon ka shumë përvojë nga puna në të gjitha rajonet në rrjetin e zhvillimit njerëzor, si dhe nga pozicionet teknike dhe drejtuese që ka pasur në rajonin e Afrikës. Ka qenë në poste të ndryshme, përfshirë postin e Drejtorit në detyrë për Tanzaninë, ndërsa detyra më e fundit që ka mbajtur është Drejtoreshë e Zyrës së BB-së në Burkina.



### **ADENIKE OYEYIOLA**

Menaxhere Praktike, Praktika Globale për Qeverisjen, Banka Botërore

Adenike Oyeyiola është Menaxhere e Praktikës për Standardet e Qeverisjes, Sektori i Kodeve dhe Sistemeve pranë Praktikës Globale për Qeverisjen të Bankës Botërore. Sektori i saj mbulon çështjet e lidhura me raportimin financiar të sektorit privat (CFRR), standardet dhe kodet e lidhura me drejtimin transparent financiar në sektorët publik dhe privat, drejtimin e brendshëm të shoqërive tregtare, ndërmarrjet shtetërore (NSH), teknologjinë dhe zgjidhjet digjitale të integruara për qeverisjen dhe shpenzimet publike dhe llogaridhënien financiare. Ka punuar në vende të ndryshme të Afrikës, Azisë Jugore, Azisë Lindore dhe Qendrore, ka udhëhequr dialogë dhe ka dhënë këshilla strategjike për qeveritë dhe sektorin privat. Para se të hynte në Bankën Botërore, Nike ka punuar në "Ernst & Young" në shërbimet e sigurimit dhe këshillimit me fokusin te aktivitetet e konsultimit dhe auditimit me risk të lartë.



### **DAN BOYCE**

Menaxher Praktike, Praktika Globale për Qeverisjen, Banka Botërore

Dan Boyce është Menaxher Praktike për Llogaridhënien dhe Raportimin Financiar në Praktikën Globale për Qeverisjen të Bankës Botërore. Aktualisht mbulon Amerikën Latine dhe Karaibet, si edhe Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore. Është kontabilist publik i certifikuar (CPA) dhe mban titullin doktor në shkenca politike nga Universiteti i Kalifornisë, Los Anxhelos (UCLA). Zoti Boyce është përgjegjës për mbikëqyrjen e cilësisë së punës në drejtimin financiar operativ të Bankës Botërore dhe aktiviteteve për rritjen e kapaciteteve të zhvilluara nga personeli i drejtimit financiar në të dy rajonet përkatëse të BB-së, përfshirë edhe udhëheqjen e nismave të lidhura me kontabilitetin, raportimin financiar dhe auditimin.



### **JARETT DECKER**

Drejtor, Qendra për Reformën e Raportimit Financiar, Banka Botërore

Jarett Decker, CPA dhe avokat amerikan, është Drejtor i Qendrës së Bankës Botërore për Reformën e Raportimit Financiar (CFRR) në Vjenë, Austri. Në CFRR, zoti Decker drejton një ekip ekspertësh të cilët ofrojnë asistencë teknike për reformimin e raportimit financiar në ekonomitë në tranzicion, ekonomitë me të ardhura mesatare dhe ekonomitë e reja të tregut. Ndër klientët përfshihen ministritë e financave, bankat



qendrore, rregullatorët e letrave me vlerë, bordet e mbikëqyrjes publike, organizatat e profesioneve kontabël dhe universitetet. Përpara Bankës Botërore, zoti Decker ka qenë Zëvendës drejtor dhe Kryeavokat për Këshillin e Mbikëqyrjes Kontabël të Shoqërive të Tregtuara Publikisht (PCAOB), i cili rregullon audituesit e shoqërive të tregtuara në bursë në SHBA. Si personi i parë që ka shërbyer në këtë rol, ka ngritur dhe drejtuar programin e ndërgjyqësisë disiplinore të PCAOB-së. Ai ka punuar si avokat i lartë për Komisionin e Letrave me Vlerë dhe Bursave të SHBA-së (SEC).



### **ANDREI BUSUIOC**

Specialist i lartë për drejtimin financiar, CFRR, Banka Botërore

Andrei Busuioc ka mbi 20 vjet përvojë në fushën e kontabilitetit dhe auditimit në sektorët privatë dhe publikë. Ai iu bashkua Qendrës së Bankës Botërore për Reformën e Raportimit Financiar (CFRR) në Vjenë, Austri, në vitin 2008, ku punon për agjendën e reformës së raportimit financiar në një sërë vendesh. Ai ka kontribuar ndjeshëm dhe ka udhëhequr disa raporte për respektimin e standardeve dhe kodeve (ROSC) për kontabilitetin dhe auditimin dhe ka njohuri prej eksperti në fushat tematike të rregullimit të auditimit dhe drejtimit të brendshëm të ndërmarrjeve shtetërore (NSH). Andrei është anëtar i Shoqatës së Kontabilistëve të Autorizuar dhe Miratuar të Mbretërisë së Bashkuar (ACCA).



### **PASCAL FRÈREJACQUE**

Nëpunës i lartë për operacionet, CFRR, Banka Botërore

Pascal Frèrejacque këshillon vende të ndryshme për përmirësimin e raportimit financiar, drejtimit të brendshëm të shoqërive tregtare dhe praktikave të auditimit dhe udhëheq veprimtari për mbikëqyrësit e sektorëve financiarë në të gjitha programet rajonale të CFRR-së, EU-REPARIS dhe STAREP. Ai ka drejtuar realizimin e programeve kombëtare për reformën e kontabilitetit dhe auditimit dhe monitorimin e NSH-ve në Kroaci, Republikën Çeke dhe Serbi. Në CFRR, Pascal ka udhëhequr publikimin e disa raporteve ROSC dhe të produkteve të tjera të dijeve: Kontabiliteti dhe auditimi i shoqërive tregtare në BE (2015), mbikëqyrësit dhe audituesit e sektorit bankar: Lidhja e një marrëdhënieje konstruktive (2016), Udhëzues për shqyrtimin e pasqyrave financiare për mbikëqyrësit (2017), Anëtarësimi i Kroacisë në BE: raste studimore për reformën e kontabilitetit dhe auditimit (2017).



### **ANA KRISTINA HIRATA BARROS**

Specialist i lartë për drejtimin financiar, CFRR, Banka Botërore

Ana Cristina Hirata Barros punon për agjendën e reformës së raportimit financiar prej vitit 2005, në Amerikën Latine dhe Karaibe, Azinë Lindore, Paqësorin, Afrikën dhe Evropën dhe Azinë Qendrore të Bankës Botërore. Është gjithashtu aktive në agjendën e drejtimin të brendshëm të ndërmarrjeve shtetërore, me fokusin te monitorimi financiar, transparenca dhe dhënia e informacioneve shpjeguese.

Është bashkautore e materialit "Drejtimi i brendshëm i ndërmarrjeve shtetërore: paketë instrumentesh" (2014) dhe materialit "Kontabiliteti për rritjen në Amerikën Latine dhe Karaibe" (2010); dhe ka kontribuar në një sërë vlerësimesh dhe aktiviteteve të asistencës teknike. Para Bankës Botërore, ka punuar në fushën e konsulencës mbi marrëdhëniet qeveritare në Brazil, vendi ku ka lindur, dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.



### **ABBAS KIZILBASH**

Specialist i lartë për drejtimin financiar, CFRR, Banka Botërore

Abbas Kizilbash specializohet në raportimin financiar, drejtimin e brendshëm të shoqërive tregtare dhe auditimin e brendshëm dhe punon në fushat tematike të rregullimit të auditimit dhe kontabilitetit dhe raportimit të sektorit publik. Ai është kontabilist i autorizuar dhe auditues i brendshëm i certifikuar me mbi 20 vjet përvojë të larmishme në auditim, sigurim, drejtim financiar dhe drejtim të brendshëm të shoqërive.

Përpara se të fillonte punë për Bankën, zoti Kizilbash ka punuar në Bankën Aziatike për Zhvillim ku ka qenë përgjegjës për të siguruar soliditetin e analizës dhe verifikimit të korrektësisë financiare të kryer për projekte në shumë vende të Azisë dhe Paqësorit. Zoti Kizilbash ka punuar edhe për Grupin Telenor, Komisionin e Letrave me Vlerë dhe Bursave të Pakistanit, Ernst & Young dhe PricewaterhouseCoopers në poste të ndryshme.





### **NATALIE MANUILOVA**

Specialiste e lartë për drejtimin financiar, Praktika Globale për Qeverisjen, Banka Botërore

Natalie Manuilova specializohet në raportimin financiar dhe drejtimin e brendshëm të ndërmarrjeve shtetërore, ku ofron këshilla për politikën dhe mbështet zbatimin e reformave për qeveritë e disa vendeve në Evropë dhe Azinë Qendrore. Drejton dhe bashkërendon punën rajonale dhe vendore për fuqizimin e drejtimit të brendshëm të shoqërive tregtare dhe përmirësimin e cilësisë së raportimit financiar dhe auditimit në të gjithë rajonin, duke bashkëpunuar me autoritetet përkatëse të Azerbajxhanit, Bjellorusisë, Gjeorgjisë, Taxhikistanit, Ukrainës, Uzbekistanit dhe Kirgizstanit. Gjatë viteve të fundit, Natalie është bashkautore për disa botime mbi drejtimin e brendshëm dhe pronësinë e ndërmarrjeve shtetërore në Azerbajxhan, Kazakistan dhe Moldavi, si dhe për Raportin e Kontabilitetit dhe Auditimit mbi respektimin e standardeve dhe kodeve në Gjeorgji.



### **ARMAN VATYAN**

Kryespecialist për drejtimin financiar, Praktika Globale për Qeverisjen, Banka Botërore

Arman Vatyán është pikë qendrore kontakti në Azinë Qendrore me më shumë se 20 vjet përvojë në nismat kryesore në nivel vendi dhe reformat e kontrollit të brendshëm, auditimit, raportimit financiar dhe IFMIS në sektorin publik në 25 vende të Rajoneve të EAQ-së, Amerikës Latine dhe LMAV. Ai drejton Komunitetin e Praktikës për Auditimin e Brendshëm të PEMPAL (23 vende) dhe programe të tjera të MFP. Përpara Bankës Botërore, ka punuar në KPMG për t'u ofruar këshilla për drejtimin e brendshëm, planifikimin strategjik, MIS, ristrukturimin, marrjet në pronësi dhe privatizimin qeverive dhe njësive ekonomike të mëdha me interes publik. Ka rreth 20 vjet përvojë në mësimdhënie si lektor i jashtëm në universitete, kurse TT, programe rajonale dhe MBA dhe në ACCA.



### **RANJAN GANGULI**

Konsulent i lartë për drejtimin financiar, CFRR, Banka Botërore

Ranjan Ganguli punon me CFRR-në prej vitit 2009 për programe të ndryshme të raportimit financiar të sektorit tregtar, përfshirë raportet ROSC për Kontabilitetin dhe Auditimin, komunitetet e praktikës të programeve REPARIS, EU-REPARIS dhe FRTAP, vlerësimin e organizatave të profesioneve kontabël dhe organizimin e mbikëqyrjes publike dhe përditësimin e publikimeve të kësaj qendre. Ranjan është anëtar i Institutit të Kontabilistëve të Autorizuar në Angli dhe Uells me përvojë në sektorët privatë dhe publikë në Britaninë e Madhe dhe jashtë saj, sidomos në Evropë dhe Azinë Qendrore si edhe në Afrikën Subsahariane. Ka punuar pranë KPMG-së nga 1987 deri në 1998, ku ka kaluar pesë vjet në Londër dhe nga dy vjet në zyrat përkatëse të KPMG-së në Hungari, Rusi dhe Republikën Çeke, ku ka ndihmuar në ngritjen e praktikave audituese dhe këshillimore. Nga vitit 1998 deri në vitin 2001 Ranjan ka punuar në Uashington si Specialist i Lartë për Drejtimin Financiar pranë Bankës Botërore. Prej vitit 2001, Ranjan punon si konsulent i pavarur i drejtimin financiar, kryesisht për Bankën Botërore por edhe për Departamentin e Britanisë së Madhe për Zhvillim Ndërkombëtar (DFID), Komisionin Evropian dhe agjenci të ndryshme të OKB-së.



### **SVETLANA PLATON**

Konsulente, CFRR, Banka Botërore

Svetlana Platon ka mbi 19 vjet përvojë në fushën e kontabilitetit dhe auditimit në sektorët privatë dhe publikë dhe në mësimdhënie në universitet. Punon pranë Bankës Botërore prej muajit qershor 2006 në një sërë rolesh dhe aktualisht kontribuon në zbatimin e aktiviteteve të programit të Partneritetit Lindor (STAREP) në lidhje me "Standardet e kontabilitetit dhe auditimit" dhe "Arsimin dhe zhvillimin e kapaciteteve" në nivel rajonal dhe kombëtar. Ka kontribuar edhe në raportet mbi zbatimin e standardeve dhe kodeve (ROSC) të kontabilitetit dhe auditimit në Moldavi dhe Slloveni, diagnostikimin e ndërmarrjeve shtetërore (NSH) në Moldavi dhe ka ndihmuar me këshilla për përmirësimin e legjislacionit për raportimin financiar në Shqipëri.